



Fletë informuese

Shumëgjuhësia në familje

A rritet fëmija juaj me disa gjuhë? Shumë urime! Me anë të kësaj ju i jepni atij shanse të veçanta! Në një mjedis shumëgjuhësh, fëmijët normalisht mësojnë një gjuhë tjetër pa asnjë mundim. Në këtë ju mund ta mbështesni fëmijën tuaj.

Çfarë gjuhe të flitet në shtëpi? - Gjuha amtare e prindërve!

Shpesh është mirë, nëse nëna dhe babai ose anëtarë të tjerë të familjes të flasin me fëmijën secili në këtë gjuhë, në të cilën ajo ose ai ndihet më e/i sigurt dhe më rehat. Shpesh kjo është gjuha e vet amtare. Fëmija juaj ka nevojë për ju si shembull në gjuhën tuaj amtare, me qëllim që ai mund ta mësojë atë në mënyrë të sigurt. Me anë të kësaj, ai njëkohësisht ka mundësi të mira për të mësuar gjuhë të tjera.


Ndjekja e rregullt e kopshtit të fëmijëve ndihmon në mësimin e gjermanishtes!

Mos u merakosni, nëse fëmija juaj në momentin e hyrjes në kopsht akoma nuk e zoton gjuhën gjermane. Megjithatë, vazhdoni të flisni me fëmijën tuaj në gjuhën tuaj amtare. Gjermanishten e mëson në komunikim me edukatorët/et dhe me fëmijët e tjerë në kopsht. Me qëllim që kjo të realizohet, ka shumë rëndësi, që fëmija juaj të ndjekë kopshtin rregullisht. Sa më shpesh që fëmija juaj të lozë me fëmijë gjermanishtfolës - për shembull në kopsht, në kënd lojërash ose edhe në një shoqatë sportive - sa më shpejt ai do të mësojë gjuhën gjermane në mënyrë të natyrshme.

Fëmijët përziejnë dhe shkëmbejnë gjuhët e tyre!

Nuk është gjë e jashtëzakonshme, që fëmijët, të cilët po mësojnë një gjuhë të re, në fillim bëjnë gabime të caktuara. Shpesh këto gabime tregojnë, që fëmijët janë në rrugën e duhur drejt gjuhës gjermane: Për shembull ata lënë nyjat në gjermanisht („gib mir Blatt“ në vend të „gib mir das Blatt“) ose ata bëjnë gabime me parafjalë („bei Baum“ në vend të „auf dem Baum“). Shpesh dhe për një farë kohe, fëmijët shumëgjuhësh edhe i përziejnë të dyja gjuhët e tyre, për shembull „Ky Ball është i imi.“, që është një shenjë për kompetencë gjuhore të avancuar. Nëse jeni

i/e pasigurt ose keni pyetje, tek edukatorët/et në kopshtin e fëmijëve ose tek pediatri juaj gjeni ndihmë dhe këshillim.



Fëmija im menjëherë flet vetëm gjermanisht!

Disa familje tregojnë, që ka faza, në të cilat fëmijët flasin vetëm gjermanisht dhe refuzojnë gjuhën familjare. Kjo nuk është arsye për t'u merakosur. Vazhdoni konsekuent të flisni gjuhën tuaj me fëmijën tuaj. Edhe si dëgjues, fëmija juaj mund të zhvillojë më tej gjuhën tuaj dhe më vonë me siguri do ta flasë prapë atë.

Të folurit jep kënaqësi!

Flisni shumë dhe shpesh me fëmijën tuaj për përvojat e tij. Tregojani atij rrëfime, lexojani atij libra ose lozni së bashku. Pavarësisht, çfarë forme të ngrohësisë gjuhore ju zgjidhni, ju i mundësoni fëmijës tuaj të lidhë ndjenja, përjetime dhe përvoja pozitive me gjuhën e tij amtare, dhe me anë të kësaj ju e për-krahni zhvillimin e tij gjuhësor.

Është një shans të rritesh me disa gjuhë!

Ju mund ta mbështesni fëmijën tuaj në mësimin e disa gjuhëve, duke i dhënë atij mundësinë të përjetojë dhe të përdorë gjuhët e tij sa më shpesh në situata të ndryshme. Gjuha juaj amtare dhe kultura juaj, por edhe gjuha e mjedisit, gjermanishtja, të bëhen të rëndësishme për fëmijën tuaj. Një qëndrim vlerësues për të gjitha gjuhët e fëmijës tuaj është një kusht i rëndësishëm, i cili e motivon fëmijën tuaj të përdorë gjuhët e tij dhe të zgjerojë njohuritë e tij gjuhore në gjuhët tuaja familjare dhe në gjuhën e re të gjermanishtes. Kështu ju e përgatisni fëmijën tuaj mirë për kopshtin dhe për shkollën.